

**Gjykata Supreme e Kosovës**  
**Ap.-Kž. Nr. 188/2008**  
**11 gusht 2009**  
**Prishtinë**

**Gjykata Supreme e Kosovës**, në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit të EULEX-it Norbert Koster si Kryetar i kolegjit, Gjyqtarit të EULEX-it Emilio Gatti dhe Gjyqtarit të Gjykatës Supreme Zait Xhemajli si anëtarë të kolegjit,

në lëndën penale kundër:

- 1. Kadri Sylejmanit, Shqiptar Kosovar, i lindur më 27/07/1981, në Obiliq, me banim në Obiliq, në Rrugën Hasan Prishtina nr. 2, emri i babait Tahir, emri i babait Sabrije, punëtor, me gjendje të mesme ekonomike, i pamartuar,**
- 2. Mirsad Kurteshit, Shqiptar Kosovar, i lindur më 01/07/1975, në Obiliq, me banim në Obiliq, Rruga e Vjetër nr. 6, emri i babait Jusuf, emri i babait Sheride, punëtor, me gjendje të mesme ekonomike, i martuar, me një fëmijë,**

për veprat penale të Pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale sipas nenit 200 (1) të Ligjit Penal të Kosovës (LPK) lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), vepra penale të rënda kundër sigurisë publike sipas nenit 164 (1) lidhur me nenin 157 (1, 3) të LPK-së dhe nenin 22 të KPRSFJ-së, Nxitja e urrejtjes kombëtare, racore, fetare a etnike sipas nenit 1 paragrafit 1.1 dhe 1.2 të rregullores së UNMIK-ut 200/4 lidhur me nenin 22 të KPRSFJ-së,

duke vendosë mbi ankesën e avokatit mbrojtës Ahmet Ahmeti, të parashtruar më 25 mars 2008 në dobi të të pandehurit Kadri Sylejmani kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të datës 8 nëntor 2007 (P. Nr. 641/2006),

në seancën e kolegjit të mbajtur më 11 gusht 2009 në praninë e të pandehurit Kadri Sylejmani, avokatit mbrojtës Ahmet Ahmeti, Prokurores së EULEX-it Annette Milk dhe Prokurorit Publik Vesel Jashari,

Sipas nenit 422 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) lëshon këtë:

## AKTVENDIM

Ankesa e avokatit mbrojtës Ahmet Ahmeti, e parashtruar në dobi të të pandehurit Kadri Sylejmani, **HEDHET POSHTË** si e palejueshme pasi i pandehuri ka tërhequr ankesën.

Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kž. Nr. 188/2008  
11 gusht 2009  
Prishtinë

### Anëtarët e kolegjit:

---

Zait Xhemajli  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

---

Emilio Gatti  
Gjyqtar i EULEX-it

### Kryetar i kolegjit:

### Procesmbajtës:

---

Norbert Koster  
Gjyqtar i EULEX-it

---

Mircea Cristian Nicoara  
Zyrtar Ligjor i EULEX-it